

# Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër  
Viti III i botimit, Janar 2009 Nr. 21. Çmimi 20 lekë.  
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

## IZRAELI PO MASAKRON PALESTINEZET NE GAZA

Shteti hebre edhe kesaj rralle e tregoi vehten si modeli i nje shteti terrorist, duke derguar tank edhe kembesorine ne Rripin e Gazes, pasi ka bere perpara nje bombardim disa ditor kunder Gazes, ku banojne mbi 2 milion palestineze dhe ku qeveris organizata muslimane Hamas e cila eshte zgjedhur qe te drejtoje pushtetin ne Palestine me votat e elektoratit palestinez pas zgjedhesh qe u quajten te lira dhe qe nuk u ankimuan nga asnje komision dhe nga asnje faktor i mbrendshem ne Palestine dhe jashte saj . Vetem Izraeli dhe ShBA nuk e njohen voten e lire te palestinezeve duke e penalizuar Hamasin si organizate terroriste. Konflikti ne mes te Hamasit dhe Izraelit eshte i pandërprere, por agresioni i trupave izraelite i diteve te fundit ka marre pamjen e plote te nje genocidi kunder civileve te cilet po bien pre e sulmeve ajrore dhe e goditjeve te tankeve qe nuk kursejne as civile ku shume nga keta civile jane edhe femije. Tashme mediat vazhdojne te japin informacione ku bota shikon shkolla te shkaterruara, ku gjejne vdekjen dhjetra femije, pallate dhe rruge qe tashme nuk njihen me nga bombat dhe raketat e ushtrise izraelite. Flitet per 600 palestineze te vrare, ku shumica jane civile dhe pohohet se jane vrare veten 7 izraelite. Pohohet me njysme zeri se disa ushtarë izraelite jane marre peng nga Hamasi. Mediat bejte te ditur se ka luftime te ashpra ne mes te Hamasit dhe tankeve izraelite, ne nje kohe qe Hamasi deklaroi se Gaza do te jete varri i ushtrise izraelite. Eshte nje ushtri qe klasifikohet e katerta ne te gjithë boten per kapacitetet e saj ushtarake, e cila eshte sulur per "te lare hesapet" nje here e mire me Hamasin nen etiketen se Hamasi sulmon me raketa "Kasam" territoret izraelite. Por, demi i mijra raketave "Kasam" ka shkatuar vetem 4 te vrare, ne nje kohe qe demet ndaj palestinezeve jane te pallogaritshme ,gje te cilen e pohoi edhe ambasadori palestinez



ne Tirane gjate nje konference shtypi. Informacionet qe vijne nga Izraeli flasin per sulme ndaj qendrave te Hamasit , kurse ne fakt bombardohen qendra te banuara ,ku pastaj kembesoria dhe tanket me snajper vrasin edhe femije .Stacioni televiziv "Al-Xhazira" trasmetoi pamje te femije te vrare me plumba ne gjoks, goditje te njohura keto si goditje snajpersh. Dhe karvanet e OKB, qe dergojne ndihma ushtarake ne Gaza, kane qene ne shenjester te ushtarëve izraelite te cilet kane vrane edhe nje shofer te makinave te ketyre ndihmave. Diplomacia nderkombetare ka reaguar me dy standarte ndaj ketyre masakrave qe po behen nga nje shtet qe e quan vehten pjese e vendeve demokratike. Amerikanet e moren ne mbrojtje si gjithmone aletin e tij dhe fajsuan Hamasin per luften ne Gaza , anipse Gaza po rrenohet nga arme moderne dhe viktimat po kapin majat. Ne nje linje eshte edhe

Anglia, sepse vete shteti hebre eshte nje krijese anglo-amerikane e cila i hapi rruge planeve izraelite per zhdukjen me dhune te palestinezeve nga tokat e tyre .Sot, numerohen me miliona palestineze te debuar nga tokat e tyre dhe ne vend te tyre jane ndertuar ngulime hebreje me te ardhur nga jashte, ku shumica e tyre vjen nga ShBA. Kurse shumica e shteteve ne bote , perfshire ketu edhe OKB, po e denojne Izraelin per dhunen dhe shkaterrimet ne Gaza. Bota muslimane eshte perfshire nga protesta te pandërprere qe filojne nga Tailanda, ku kerkohet shkaterrimi i shtetit hebre dhe perfshijne Turqine , Indonezine, shetet e Lindjes se Mesme ,pa harruar se dhe Evropa po proteston ne te kater anet e saj kunder genocidit ne Gaza. Vetem shqiptaret nuk protestojne per probleme qe kane lidhje me deminimin e krimeve qe behen kunder civile. Ky fenomen eshte pare edhe

ne shume raste te tjera, gje qe duket se ne, per hir te miqesive "se mikut te mikut tone", jemi gati te penalizohemi si pjese e atyre qe "u vene noten kalueshem" masakrave qe behen ndaj civileve ne Gaza. Tashme eshte njoftuar se Keshilli i Sigurimit ka kerkuar nga Izraeli qe te ndaloje ofensiven ne Gaza , vendim qe eshte hedhur poshte nga parlamenti izraelit ,duke treguar keshtu arrogancen eshtetit hebre qe duket se eshte i paprekshem edhe nga rezolutat e organizmave me te larta nderkombetare. Ka shume mundesi qe partite politike ne Izrael kane nevojë per te mbajtur ne kembë nje lufte ne Palestine, per te fituar kapital politik ne pragun e zgjedhjeve qe po afrohen ne shtetin hebre, anipse ky kapital politik kullon gjak nga viktimat civile ne Palestine.

Selim Gokaj



# DEKLARATE E FORUMIT MUSLIMAN SHQIPTAR

**F**orumi Musliman i Shqipërisë po ndjek me shqetësim të thellë ngjarjet e ditëve të fundit në Rripin e Gazës, ku ushtria izraelite, ne cilësinë e okupatorit të tokave palestineze, po bombardon pa mëshirë, në kundërshtim me të gjitha kartat e rezolutat e OKB-së dhe konventat e të drejtave të njeriut si dhe me ligjin ndërkombëtar të luftës, vendbanime civile, shkolla e universitete, seli qeveritare dhe ente publike të Rripit të Gazës.

Numri përditë e në rritje i viktimave civile si pasojë e bombardimeve na kujton epokën e hidhur të luftës së 1967-tës kur ekspansioni i shtetit izraelit ndaj tokave palestineze shënoi krime të ngjashme me ato që po zhvillohen edhe sot. Forumi Musliman i Shqipërisë denoncon fuqimisht aktet e dhunës cioniste manifestuar me sulmet ajrore mbi popullsinë civile, si pararendëse të një prapavije të errët e cila synon cungimin dhe shkatërrimin e shtetit të Palesti-

nës.. FMSH, ndanë në të njëjtën kohë dhimbjen e tij me popullatën e masakruar të Rripit të Gazës duke i qëndruar asaj pranë shpirtërisht e moralisht, duke u solidarizuar me përpjekjet e tyre titanike për rezistencë ndaj pushtimit 60 vjeçar, dhe në të njëjtën kohë duke shprehur dhimbjen e tij për të lënduarit dhe të vrrarët. FMSH i bën thirrje faktorit politik ndërkombëtar si dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që në respekt të kuadrit rregullator ndërkombëtar

që ato vetë kanë ngritur dhe aprovuar, të ndërhyjnë fuqimisht dhe sa më parë për të ndaluar masakrat e mëtejshme me pasoja të paimagjinueshme mbi popullsinë civile. FMSH i apelon organizmave në fjalë që të parandalojnë masakrën në Gaza, e cila mund të ketë pasojë të rënda për marrëdhëniet gjeopolitike ndërkombëtare.

**FORUMI MUSLIMAN I  
SHQIPËRISË  
TIRANE**

## NE TE GJITHE BOTEN PROTESTOHET KUNDER SHTETIT IZRAELIT

**G**enocidi i pameshirshëm i Izraelit që nuk ka ndalur në Gaza ku numri i viktimave ka arritur numurin 900 ka shokuar të gjithë botën me egersinë e tij të papare ku një ushtri e superarmatosur po perpiqet t'i japë mesim të mirë Hamasit që të mos godase me raketa me territorin Izraelit. duke u mbështetur në këtë slogon jo shumë bindës masakrat janë drejtuar kundër civile të pambrojtur kun e mes të civileve janë edhe 300 femije.

Askush nuk beson se ata femije janë të afte të godasin me raketa "Kasam" territorin izraelit dhe po askush nuk beson se ata femije janë terroriste. Ajo që arrijnë të bëjnë disa nga këto femije është të he-

dhin gure kundër tankeve izraelite të cilët me blindat e tyre nuk pyesin shumë për gure që hidhen kundër tyre. Por ushtria e shtetit hebre vret femijet palestineze si pjesë estartegjise se njohur të saj për të krijuar dhimbje të padurueshme në rrallet e kundërshtarit që ai të humbase betejën me ushtrinë izraelite. Por në terren ku trupat izraelite janë perballë luftetareve të Hamasit rezultatet nuk janë të njëjta site vrasesh femije Mediat japin lajme për ushtarë izraelite të zënë rob dhe ministri i mbrojtjes së shtetit hebre Barak nuk e quant e lehte inkursionin e ushtrisë izraelite në Gaza, sepse ai e di që aty e presin repartet e Hamasit që nuk kanë armë sa ushtarët hebrej por kanë avantazhin se luftojnë në token e

vet kundër një pushtuesi të huaj. Vrasjet e popullsisë civile nga avionet, tanket dhe artileria izraelite kanë irrituar të gjithë botën. Behet fjale për protesta që kanë shpërthyer në shtetet muslimane dhe po kështu demonstratë të fuqishme po zhvillohen edhe në Evropë dhe në hapësira të tjera jomuslimane, ku protestuesit po kërkojnë të ndalet sulmi mbi oalestinezet në Gaza. Keshilli i sigurimit ka vendosur që t'i bejë thirrje shtetit hebre të ndalojë sulmin në Gaza, thirrje që parlamenti izraelit e ka hedhur poshtë, duke treguar se aid he prapavija e tij ushtarake dhe politike nuk pyesin për organizma të tilla të rëndësishme ndërkombëtare si OKB dhe institucionet e saj. Analistë ndërkombëtarë pranojnë se

incursion hebre në Gaza i ka sjelle një dem të pallogaritshëm shtetit izraelit nearenen ndërkombëtare sepse ai po portretizohet atshme si shtet terrorist që godet dhe vret civile ku femijet janë ata që vriten pa meshirë duke rrenuar shkolla dhe vende të tjera strehimi, ku femijet dhe nënat e tyre mendojnë se janë të mbrojtur. Ka mundësi që kur të mbarojë lufta në Gaza shteti Izraelit të shpalle fitoren e kesaj lufte dhe humbjen e Hamasit. Por ajo do të jetë në fakt një fitore e hidhur sepse pas saj endron një masaker ku nuk u kursyen as femijet e vegjel

**Materjali është pergaditur  
Duke u bazuar në informacionin  
e mediave**

## IZRAELITET SULMOHEN NGA TIFOZE TURQ

**G**jate një ndeshjeje basketbollite zhvilluar në Stamboll të Turqisë në mes një skuadre turke dhe një skuadre izraelite, në kuader të kupave të Evropës, tifozet turq, nga shkallet e salles sportive ku po zhvillohej ndeshja, sulmuan sportistët e Izraelit

duke e detyruar arbitrin e kesaj ndeshjeje që të pezullonte takimin, sepse dhuna mori pamje të rrezikshme. Tifozet turq hodhën parudha të tilla si; Izraeli është vrases dhe se ate që Hitleri u ka bërë hebrenjve, sot hebrenjtë po ia bëjnë palestinezëve. Ky incident tregon se nuk mjaftojnë mard-


heniet e mira që ka shteti turk me shtetin hebre për të kaluar në heshtje masakrat e pen-degjuara që po bëjnë trupat izraelite në Rripin e Gazës. Jane pikerisht këto masakra që i kanë bërë të mbajnë qëndrin antiezraelit qeveritaret e shtetit turk dhe opinjonit publik në Turqi duke u bërë

keshtu pjesë e protestave masive që kanë përfshirë të gjithë botën e cila po proteston kundër sulmit izraelit në Gaza, duke bërë kështu që zemrimi kundër shtetit hebre të kalojë nga politika edhe në sport.

**Sipas mediave vizive**

# TE DHENAT E LIBRIT

## “HISTORIKU I XHAMISE QYTETESE NE SHQIPERI - XHAMITE E TIRANES”



**K**y libër është pjesa e parë e një libri disa-vëllimesh i titulluar: “Historiku i xhamisë qytetëse në Shqipëri” dhe pjesa e parë titullohet “Xhamitë e Tiranës”. Ka si autor gazetarin dhe hulumtuesin Roald A. Hysa, që është edhe puna e parë e tij që po sheh dritën botimit. Ndërkaq ky autor ka edhe disa libra të tjerë ende të pabotuar (shih roald-hysa.com), si dhe në proces punimi disa të tjerë. Ky libër ka 120 faqe dhe përveç materialit tekstor është i plotësuar me një material të pasur fotografik, të cilat e ilustronjë më së miri temën e përzgjedhur të autorit. Në këtë libër ka 170 foto bardhë e zi dhe me ngjyra (76 foto bardhë e zi, 91 me ngjyra, 5 harta ilustrative dhe nga totali i 170 fotove 85 prej tyre botohen për herë të parë në një libër, ku dallojnë tre beraete sulltanore dhe foto e Hafiz Ibrahim

Dalliut e nxjerrë gjatë kohës kur ai ishte i arrestuar). Gjithashtu mund të themi se për shkak vendi jashtë këtij libri janë lënë shumë foto ilustrative. Ky libër është ndarë në dy pjesë kryesore ku në pjesën e parë flitet për lindjen e Tiranës dhe legjendat rreth saj, si dhe për zhvillimet urbanistike të saj që kanë në bërthamën e tyre xhaminë e lagjes dhe përqendrimin rreth xhamisë të lagjes dhe shtimin e banesave qytetare rreth kësaj xhamie. Gjithashtu janë dhënë edhe ndryshimet politiko-historike që ndodhën gjatë periudhës së parë të themelimit të Tiranës, por më të rëndësishme do të thoshim se janë ato të passhpalljes së Tiranës, si kryeqytet i Shqipërisë dhe i Shqiptarëve në vitin 1920. Një tjetër periudhë kohore e rëndësishme është edhe ajo pas vitit 1945- e deri 1967, kohë kur nisi spastrimi fetar dhe i xhamive njëkohësisht.

Në pjesën e dytë të këtij libri jepen sqarime mbi konceptin arkitektonik të xhamisë dhe pozitën e saj brenda bashkësisë, si dhe për ujin që është një element i vlefshëm qytetërimor, jo vetëm për një popull, por është edhe një element bazë i bashkësisë dhe i xhamisë.

Po ashtu më pas janë rreshtuar 27 xhamitë dhe objektet e tjera islame të kryeqytetit, ato që janë ekzistuese dhe ato që nuk janë më. Të gjitha këto janë të shoqëruara me një material të pasur fotografik e informativ, me vendndodhjen dhe se kush janë sponsorët financiarë të këtyre objekteve.

Një nga gjërat më interesante të këtij botimi është se ky libër është botim dy-gjuhësh- shqip-anglisht. Krahas versionit shqip jepet edhe versioni anglisht i përkthyer mjeshtërisht nga pedagogu

gu i universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës dhe që është një përkthyes i mirënjohur tashmë, Edvin Cami dhe pjesërisht nga Armanda Hysa.

Një libër i një formati të tillë botohet për herë të parë dhe për nga ndërtimi ka pasur konsulentencën e prof. Ali Muka, etnolog dhe specialist autoritet në fushën e ndërtimeve autentike shqiptare, i cili ka bërë edhe redaktimin shkencor të librit. Po ashtu pjesë e konsulentencës shkencore të librit është edhe mag. Armanda Hysa, e cila është antropologe dhe studente PHD me tezën e pazareve dhe çarshive në Ballkan dhe të Pazarit të Vjetër të Tiranës.

Një pjesë e redaktimit gjuhësor është bërë edhe nga Edvin Cami.



# MUSLIMANET NUK DUHET TE FESTOJNE VITIN E RI



Festat janë dukuri e rendesishme e jetes njerzore dhe askush nuk ka te drejte qe te penalizojë asnjë festë duke i klasifikuar ata ne festa te mira ,ose festa te kufizuara ne vlera. Por, diversiteti është i pranishëm edhe ne festa, sepse shoqëria njerzore është e ndare ne popuj dhe kombe, te cilet kanë edhe religjonet e tyre qe mund te perfshijë një komb, një popull, ose disa popuj e kombe se bashku. Kjo do te thote se ka festa kombetare , nderkombetare dhe me parametra te tjere vlerash , por qe gjithmone te pranueshme dhe te zbatueshme ne hapësira te caktuara. Problemet e festave fetare janë pak me specifike ,sepse ata janë me rigorozë ne zbatueshmerine e tyre, ku secila fe i ka te percaktuara festat e veta qe i dallojnë ne shume aspekte nga festa laike. Besimtaret e secilit religjon janë te porositur qe te festojne festat qe i perkasin religjoneve te vet, pa penalizuar festat e religjoneve te tjere. Ne një ambjent, ku une pohova se nuk e festoj festën e Vitit te Ri, një person i një religjoni tjetër me tha se po na fyen ne. Debatuesi u detyrua qe te pranojë pergjigjen se secili religjon ka festat fetare te tija dhe se respekton festat fetare te te tjereve dhe se nuk është fetare qe t'i imponohen festat e religjoneve te tjere. Mendojme se ky debat është moment për te hape një debat tjetër i cili lidhet me pyetjen se cilat janë festat qe duhet te festojne muslimanet dhe a është e lejuar për një musliman te festojë festën e Vitit te Ri. Për muslimanin, festat fetare janë te sanksionuara fetarisht, duke filluar nga Fiter Bajrami dhe Kurban Bajrami dhe duke vazhduar me te tjerat, qe janë te dhena ne kalendarin musliman, ku secila feste është dhene me datën perkatese qe do te njihet nga besimtari musliman për ta festuar. Muslimani e ka te ndaluar te festojë festat qe nuk kanë lidhje me

fene islame dhe i perkasin një feje tjetër. Një rast i rrezikshëm është festa e te ashtuquajturit Viti i RI, i cili ka fituar te drejten e festimit edhe tek një pjese e madhe e muslimaneve. Thuhet se është feste popullore, kur ne fakt është Shen Vasili ,një feste e njohur ortodokse. Thuhet se është pema e Vitit te Ri, ne një kohe qe është pema e Krishtelindjeve , sepse asnjë familje katolike nuk e heq nga shtëpia pemen e Krishtelindjeve për te vene ne vend te saj pemen e Vitit Ri, sepse nuk ka peme te Vitit te Ri, por është pema e Krishtelindjeve qe mbahet deri pas Vitit te Ri. Ky arsyetim do te ishte i mjaftueshëm për ata muslimane qe zbukurojnë një peme për Vitin e Ri, për t'i bindur se ata po zbukurojnë pemen e Krishtelindjeve ne shtëpinë e tyre. Thuhet se janë femijet qe na detyrojnë për te festuar Vitin e Ri, ne një kohe qe për femijet duhet te festohet madheshtor Kurban Bajrami , Fiter Bajrami dhe te shoqerohet edhe me dhurata ,qe femijet ne familjet muslimane ta marrin vesh se kush janë festat e tyre te verteta. Muslimani duhet te kujtojë edhe porosinë e profetit , Muhamedit a.s. qe na porosit se ata qe imitojnë te tjeret, behen si ata. Te mos harrojmë se sot ndaj muslimaneve, kudo ne bote, pa perjashtuar edhe Shqipërinë, behen perpjekje qe te cenohet dhe te goditet identiteti i muslimaneve. Dhe një mundësi, qe paraqet rrezik për muslimanet ne kete fushe, është perpjekja për t'i mesuar qe te festojne Vitin e Ri, I cili nuk ka te bejë ne asnjë parameter te tij me muslimanet dhe me fene islame. Ky qëndrim ndaj Vitit te Ri nuk është oponent kundër religjoneve te tjere, por është një respekt për keto religjone, respekt qe buron nga vete natyra tolerante e muslimaneve dhe e vete fese islame.

Alban Kastrati

## ZGJIDHJE HYJNORE PËR NJERZIMIN

Nga maja e lartë e Mekes Profeti a.s. percjell mesazhin  
për botën

Duke na thënë te shpëtojmë vehten nga zjarri i  
xhehnemit

Se Ai nuk ka ne dorë tek Allahu asgjë për ne.  
O ti...! Ky zë i kumton mesazhin prej asaj kodre  
hapesirave ranore

Dhe me tej deri tek ne.

Ne humbetire ndëgjova zerin dhe u zgjova nga gjumi i  
rende

Një gjumë qe kishte mberthyer shpresat e mia ne kete  
bote.

Zeri leviz n'trupin dhe mendjen time dhe le gjurmë te  
mesazhit te madh

Si lule te fresketa ne shkretire.

Dhe ndjenja te forta shprese lulezojne ne shpirtin tim.  
Tashme shpresa, si një grusht i fuqishëm godet shpirtin  
tim

Dhe trondit mbrendesinë e tij te semure dhe pa  
rrugedalje.

Ndjej lot, dridhje. Qaj se zeri i tij me zgjoi nga gjumi

Me dha oksigjenin qe te jetoj, se me mungonte.

Ishte thirrja e Tij qe jetes m'i dha ngjyre t're  
Tirrja e Profetit tim, zgjuesit tim m'tha: zgjohu!

Isha zhytur n'ferr pa kthim, ku ushqim kisha  
kenaqesinë boshe.

Thirrja profetike e Profetit as. ishte sherimi im.  
Thirrja e tij ishte uragan qe m'mori me vehte ne  
shpetim.

M'zhveshi nga rrobat e gjynaheve t'kesaj bote.  
Zgjim qe zgjati!

Ze qe m'zgjoi e ndryshoi jetën time.

Dhe tek une zeri i Profetit a.s. ngrihet dhe shuhet.  
Une ve veshin perseri n' kohe dhe n'dridhjet e botes.

Zeri vjen serisht i kthjellet prej asaj kodre  
Dhe egos sime pa fre i thote :Ndal!

Samir Hoxhiq

Medrezeja Haxhi Sheh Shamia

Viti iv



# HALLET E SHQIPTARIT

Hall të fort ka sot shqiptari,  
Me lanë trojet që ia Ia pari;  
Me marrë rrugat e gurbetit,  
Ne faqe t' tokës , në shpind t'  
detit...  
Nëpër lugina edhe male,  
Dikush z bath, dikush në  
sandale...  
Tjerët me varka e me sandale,  
Të rrethuem gjithmon me halle,  
Çanta në shpind, më fëmijë në  
krahë,  
Me t' thanë mendja dreqi u  
grahë...  
Dikush qanë, dikush bërtitë...  
Porsi huti pulat turitë.  
E për tjerët që i lanë mbrapa,  
Ves-vesi i ndjek me hapa...  
T'lagun qull e t'merdhitun,  
Nga uja e friga t' tupitun...  
Nuk numrohen hallet tjera,  
Që shqiptari i ka te dera...  
Edhe deti veshtirë e ka,  
Me rrefy për sa ka ka pa...  
Sa e sa njerëz ai ka përpi,  
Nga gjithë moshat ... edhe fëmij.  
Edhe toka në anën tjetër,  
Ka kalbë te rinj dhe t' vjetër...  
E ata që kanë shpëtu,  
Vështirsive janë nenshtru:  
Rrethue nga ankthi e urija,  
Pushtu friga ... pasiguria...  
E tue i ra gjithkuj në duar,  
Kërkojn bukën ne dhe t' huej.  
E gjithkund rrin t'u u struk,  
Lotë t'përgjakun përzi me  
bukë!...  
Në vend që t'rrijë në votër t'vet,  
Bahet pre në tokë e dete...  
E keqja, sot, e ka mberthy,  
Atdheut shpinden ia ka kthy.  
Në ata troje plot bereqet,  
Ku diell e hane gjejn lezet.  
E shqiptari atje në mërgim,  
Në meshirë t'tjerve lypë  
strehim...  
Kur hyp në shpind t' gurbetit,  
Si me hyp në vele t'detit...  
Se ku t' qesin Zoti e dinë,  
Rrezik asht që edhe t' përpijn...  
Me t'u dhimbet ba shqiptari,  
Në Evropë... ba plaçka pazari;  
Për pak euro, e pak pare...  
Shitet sot femna shqiptare.  
Ah, ajo femer që dikur...  
Për kah nderi ishte nur,  
Ishte nur e bante dritë...  
E kto punë... kurr s'i ka dit!  
Si ka dit si ka punu,  
Për mirësi gjithkund dallu!  
E djemt tonë si petrita,

Dalin rrugve... pa zbardhe drita:  
Dikush në t' zezë . dikush me  
letra,  
I kanë ra t' keqës në kthetra.  
Aty mbesin gjak e mish...  
E Evropa qejf s'prish;  
As prishë qejf as lezet,  
Në qorrsoak... shqiptari mbet.  
Mundu per vehte e babë e nan,  
Qe n'Shqipni ,diku i ka lan...  
I ka lanë në hall e siklet:  
Me trup n' Shqipni, me mend n'  
gurbet...  
Në vend që t' jenë në  
universitete...  
Punojn në fshatra e qytete...  
Të zijet e ullinit gjithkund heq,  
Por në Greqi asht ma per dreq!  
Nga zori... grekut i hyni në  
vathë...  
Nga çdo e drejtë ... çvesh e  
z bathë.  
Burr i keq asht fukaralleku,  
Prej tij mund t' vij qafirleku!  
Deri dje greku fukara,  
Sot në mjaltë shpata i ka ra...  
Por kur te hori bjen paraja:  
Ngusht e zor e ka dunjaja!  
Ndër toka tona argat punoi,  
Sot na hiqet "efendikoj".  
Me përçmim ai i shfrytizon...  
Me folë Shqip, kush s' guzon.  
Me ba ndryshe gjenë belanë,  
I trajton ...si i keqi gjanë.  
Me zor në kishë i dergon,  
Me uje t'urrejtjes i pagzon...  
E çka i bajn shqiptarit sot...  
Krisht as Bibel ashtu s'thotë.  
Por ka herë... butë e ka gjet,  
Per me ba çka don, ai vet.  
E vet Perendimi e llaston:  
Djeg e shuen... ku maston.  
Në antarsi ai pjesë ban:  
T' Bashkimit Evropjan.  
Edhe në Nato asht antar,  
E na hiqet fort krenar...  
Kshtu banë greku, kush si flet...  
Ne shekullin tonë njenjizet.  
Kush nuk flet as hap me gojë,  
E vazhdon greku me lojë...  
Edhe në Bibel e bajn benë...  
Turp e marre duhet t' kenë.  
Që këtë vehtes ia lejon,  
Para botës vehten zvoglon.  
Por atë gajle ai se ka,  
Me ba keq mendjen ka nda...  
Ka nda mendjen e ka qite:  
Asht krenar me kenë me t'kqijt.  
Vuen shqiptari nën gur  
t'pendimit,  
Në oborr t'Perendimit...

Per atë pune... as si hane palla,  
Nuk i levizë aspak qepalla!  
Shqiptari jetën e vazhdon:  
Kurrizin ulë, kryet se çon.  
Pa shkop , veç me t' bertitun,  
E merr para si te turitun.  
E ka lodhe ... ba për një lek,  
Sipas qejfit e debon bizlek...  
Nëpër fusha, kanale, ura...  
Punojn gra, edhe burra...  
E të gjithë janë ba argat,  
Ju rrinë greku si xhelat;  
Si xhelat me shkop në dorë,  
I rraskapit e i banë hor.  
Me ba 'zus' kërken s' lenë,  
Se përndryshe s'kanë vend...  
S' ka vend, as kanë ku shkojn,  
Të ramet... rrijn e i numrojn...  
Kshtu i erdh puna shqiptarit,  
Me iu vue ky soj ullarit...  
E çon në ujë, e bien pa pi,  
E gjithkah... ia ka ba zi.  
Në Greqi jeton në gazep,  
Me mend t' veta merr e jep:  
I padurushem , ba ai vathë,  
Diku tjetër don me ia mbath...  
E gjithmon ne dorë t' rrezikut,  
Me i thanë" dajë" edhe anmikut.  
As në vend t' vet se len rehat,  
E gjithkund... ia banë bajat...  
Dhambët shtërngon ... e i  
kërcnohet,  
Pa votë tij askund s'pranohet...  
E ku te doj kisha... ndërton,  
Veç me shej i piketon...  
Me i thanë:"Jo!", kush s' guzon,  
Se përndryshe keq e pëson...  
E kshtu greku na krekoset,  
Shtrembnon ftyren... e kanoset.  
Qeverija rrudhe me krah,  
Si thotë greku punve iu grahë...  
Vazhdon shqiptari në mërgim,  
Shikon me gjetë diku shpëtim:  
E diku... me shku shpreson,  
Veç në Shqipni me u kthye s'don.  
Valle në këtë shkalle kush e çoi,  
Që në vend t' vet s'don t'jetoj!  
E çdo gja iu asht neveritë,  
Sikur n' Shqipni s' ka ma dritë?  
Komunizmi e dërmoi,  
Sikur gjakun ua ndrroj...  
E ka zhdukë çdo gja shqiptare,  
E bani popullin për pese pare!  
Miqësi me sllave, herë me kineze,  
Me koreane, e vjetnameze...  
E u ba një soj mishmashit,  
Porsi fija që i humb lamshit...  
Jep e merre me lamsh në dore,  
Zgidhja e tij bahet me zor...  
Ba shqiptari i çoroditun,  
Ora e re... e gjete t' habitun

Në vend t' vet e bani t' huej,  
Ia ka ba po gjakun uje...  
E anmiku kurr s'pushon;  
Intriga t' ndryshme ai sajon:  
Lloj-lloj llafesh... qet për ditë,  
Që shqiptarin me turit;  
Me turit e me largu,  
Në vend t' vet ma mos me shku.  
Në errësinë këto i sajojn...  
Që vet shqiptari t'i besojn:  
"Se" gjoja" Shqipnija asht  
mallku...  
I madh e i vogël me leshu".  
Na kurr s'duhet t' gabojm,  
Që kto llafe t'i besojm!  
Sado mirë t'jeni ne vend t' huej,  
Kurr nuk jeni si ne dhe tuej!  
Se vete jeta e ka dhanë:  
Me i thirrë: babë e nanë.  
E si thue puna do te bahet  
Vall, halli ku mund t' qahet?  
Pasha Atë, që shpirtin i dha,  
Këtë përgjigje në dorë e ka:  
E ka në dorë vetë shqiptari,  
Me ba atë që bani i pari:  
Vendin e vet kurr se lëshuen,  
Të huejt... gjithmon te ai punun.  
Mirë duhet t' shtërngohet,  
Pa përpjekje, luftë s'fitohet!  
Kur t' punohet si një dorë,  
Mbi fitore venë kunorë.  
Me za t' qart Atdheu thërret,  
Përgjigjen tonë ai e prët:  
Me zemër e shpirt pran t'i rrijm,  
Pa ngurrim me i dhanë ndihmë .  
E këtë shkallë kur t'a arrijm,  
Si jetim ma s'do të rrijm.  
Greku e t' tjerët vesht t'a marrin:  
Ma nuk luhet me shqiptarin!  
Kur Shqipnija t' ketë qetsi,  
Tokë e qiell do t' kenë knaqsi.  
Shqiptari vehten do t'a njohin.  
Edhe t' tjerët do t'a shohin.  
Se kur rast shqiptari t'ketë,  
Ai mbrapa kurr nuk mbete!  
Ece shqiptar, mos ngurro,  
Kohën e humbun, sot ,fito!  
Me punën tande , e ndihmë  
t'Zotit,  
Prap do t' jesh ,ai, që ishe motit!  
Ditë të mira prap do t'vijm,  
Për shqiptarin dhe Shqipnin.  
E për kto që unë shkrova,  
Në korriz tim disa... i provova!  
Me plot zemër i lutem Zotit,  
Që shqiptari mos t'vuej mbas  
sodit!

# JETET NJEREZORE, MBETURINA TE GLOBALIZMIT

**G**lobalizimi do të shpëtojë botën", "do të sjellë mundësi të barabarta"... janë moto qesharake me të cilat mediat tallen me jetën e miliona njerëzve. Shifrat dëshmojnë të kundërtën. Një masë prej vetëm 20% zotëron 86% të pasurisë së botës, përballë 70% që kishte 30 vite më parë, ndërsa 20% në fundin e diagramës numërojnë vetëm 1,3% të pasurisë së globit. Nga një raport Veri-Jug (i botës) 2 me 1 i shekullit të XVIII, arrihet në 30/1 në vitin 1965, gjer tek 70/1, në humnerën e pasurisë mes dy hemisferave. Kapitali i tre personave më të pasur në botë është më i madh se GDP -ja e 48 vendeve më të varfëra të globit. 100 ndërmarrjet më të mëdha të botës prodhojnë në total 4.000 miliard dollarë, 15% e prodhimit botërorë duke punësuar vetëm 12 milion njerëz. Këto kolosë kanë rritur fitimin nga 1993 në 1996 me 24% dhe në të njëjtën periudhë kanë reduktuar personelin me 0,5%. Taksat ndaj këtyre monopoleve kanë zbritur duke varfëruar buxhetin e brendshëm të shumë shteteve qoftë edhe më të zhvihuara të botës. Financa transporton brenda ditës 1.300 miliard dollarë ndërsa shkëmbimet globale në mallë konsumi janë 20 herë më të vogla. Cmimi i fucisë së naftës ka rënë me 40 dollarë(nga maksimumi i ditëve më përpara) ndërsa benzina rritet sëbashku me produktet e tjera jetike. Në SHBA falimentojnë banka. Kriza financiare e modelit të "Sudes" së Shqipërisë të një dekade më përpara lëkund botën. Ajo do të tejkalohet nga miliarda dollarë të taksapaguesve në shtetet specifike(të goditura direkt nga kriza) dhe banorëve të tjerë të globit që përballen cdo ditë me cmimet ndërsa Buffett, Gates, Soros etj pasurohen. Kriza është e bankave dhe e sistemit që nuk kontrollon kapitalin por viktima që paguan është masa.

Këto shifra rrëqethëse të lëna në hije nga mediat që mbushin programet me sport, çfarë qeni ka Paris Hilton, balena që ka humbur rrugën, berberi në Izrael që përdor 10 gërshërë njëkohësisht, vendosin një pikëpyetje të madhe për të ardhmen e njerëzimit. Mediat gjatë edicionit të thjeshtë informativ gjejnë 120 sekonda për një fokë të cilën e shpëtuan disa animalistë, por nuk gjejnë asnjë sekondë për varfërimin e përditshëm të njerëzve. Dy janë mënyrat e errësimit mediatic të varfërisë dhe devijimit

të shkaqeve të vërteta të sajë :

Së pari, trasmtohen disa vende dhe popuj që vuajnë për bukë dhe ujë, të llogaritur në 800 milion banorë. Në imazhin e një banori kryesisht perëndimorë këto janë vende të largëta, thuajse jashtëtokësore që nuk arrijnë dot të civilizohen për fajin e tyre. Shpesh si krahasim (kundërpeshë) përdoren " 4 tigrat" e largët me prosperitetin ekonomik, teknologjinë e lartë, mirëqënjen, qëndrueshmërinë etj. Me një gurë vriten dy zogj. Këta individë fajësohen për gjendjen e tyre edhe pse është Perëndimi që vjedh lëndët e para, u shet armë të të gjitha llojeve duke filluar nga minat antinjerëzore gjer tek armët kimike, u përmbys qeveritë e vetëzgjedhura duke u dhënë leksione demokracie-totalitare. Katër tigrat prezantohen si model i arritshëm, por anashkalohet një e vërtetë historike. Këto tigra do të ishin mace për të mos thënë minj nëse nuk do të ndodheshin në kufinj të konfrontimit të faktorëve të Luftës së Ftohtë. Malezja përballë Vietnamit, Korea e Jugut përballë modelit komunist të motrës së Veriut, Taivani i shkëputur nga trangu historik dhe Singapori me pozitën strategjike të krahasueshme me pak shtete të tjera të botës. Cili nga vendet e tjera, të kësaj bote të largët të uritur që hyn në 99%-shin e popullsisë së këtij grupi "alien", ka fituar lotarinë e tigrave që përbëjnë vetëm 1% të të "huajve"? E dyta viktimitë në këtë manipulim është reduktimi i varfërisë tek e thjeshta uri. Kjo destinon fokusimin vetëm tek 800 milion njerëz dhe jo tek 4 miliardë që jetojnë nën kufirin e varfërisë. Fëmijët e uritur mund të indinjohen njerëz filantrop por pengojnë ato të shkojnë në thelbin e cështjes, tek varfëria dhe burimet e saja. Përse për keto 4 miliardë koha nuk ecën dhe nuk ka ngjyrat e kohës të pakicës së individëve? Përse nuk kanë të drejtë të mbijetojnë ndërsa homologët e tjerë shpërdorojnë duke përcaktuar si parësorë dëshirën për konsum? Përse këta miliardë duhet të njohin kufij ndërsa pakica udhëton me avionë nga një hapësirë në tjetrën? Së dyti, pjesa e uritur (jo e varfër) e rru-zullit tokësorë paraqitet si e huaj dhe e jashtme që nuk "na" përket. Cdo gjë që vjen nga kjo hapësirë lidhet me luftën, sëmundjen, urinë, diktaturën, drogen, krimin, emigracionin, papunësinë, varfërinë, konservatorizmin, integralizmin etj. Produkti i kësaj demagogjie të

përditshme janë jetët njerëzore të barazuara me mbeturinat që vlejnë për pakicën vetëm për të vendosur në evidencë "madhështinë" dhe të drejtën e saj arrogante për të sunduar nëpërmjet përjashtimit. Kjo masë e uritur nuk kërkon mëshirë dhe bamirësi që shpesh është vetëm fallsitet, por përfshirje në vetëvendosje, në administrimin e ekonomisë dhe pasurive kombëtare, në nacionalizimin e saj që nuk do të thotë shtetëzim sipas modelit komunist, në oportunitete të barabarta, në të drejtën për t'u ushqyer, shkolluar, jetuar globalizimin ashtu sic e jeton elita e globit. Globalizimi shndërrohet në "glocalizim" - pohon Roland Robertson - që do të thotë përqëndrim i kapitalit në pak duar dhe përqëndrim i lirisë së lëvizjes dhe veprimtimit në të njëjtat duar. Kapitali lokalizohet tek ata që lëvizin lirshëm ndërsa shumica çlokalizohet në aspektin financiar dhe lokalizohet(territorialisht) në formën e bantustanëve të Apartheidit afrikanojugorë. Bota edhe në aspektin e lirisë strukturohet në formën e kastave indiane ku shumica është e destinuar të "burgoset" pas një muri imagjinarë që e mban në sferat më të ulëta të kësaj piramide, ajo nuk ka të drjetë të lëvizë. Pakica konsideron pjesën tjetër një hambarë furnizimi me lëndë jetike dhe laborator seleksionimi njerëzorë emigrantësh të domosdoshëm për t'i shërbyer elitave të ndërtojnë "Piramidat" e globalizimit. Kjo mund të konsiderohet si përmbledhje esenciale e domosdoshmërisë së "elasticitetit të tregut". Sot, "liria" e zhatjes, e trajtimit të njerëzve si mbeturina, e mishëruar nga bankat dhe institucionet financiare jo vetëm që vërteton fjalet e Robertson por ka vendosur globin përpara një regresi ekonomik duke ringjallur 1929-ën. Sigurisht rrezikon masën sepse fajtorët(bankat) do të shpëtohen me justifikimin që janë jetikë si Zoti. Ironia është se nuk do t'i shpëtojë Zoti, por ne, viktimat e vjedhjeve të ligjshme. Administratori i njërës prej bankave fitonte 17.000\$ ne orë. Duhet 1 euro në ditë për t'i dhënë të drejtën e jetës një fëmije të dënuar me uri. Vetëm në një ditë ky Zotëri fitonte një shumë të barabartë me jetën e 350.000 individëve.

Para ca kohësh, konkretisht gjatë olimpiadave të Pekinit u bombarduan nga mediat që përcillnin mesazhet e politikës e cila i kërkonte Kinës liri dhe të drejta për qytetarët e saj - sikur këta i përkasin Fran-

cës, SHBA-së, Gjermanisë, Britanisë etj, shtete që kanë robëruar këtë popullsi jo më larg se një gjysëm shekulli më përpara - së bashku me pushtimin e ekraneve të cështjes Tibetiane. Në gjendjen e Tibetit ndodhen mjaft popuj, të katandisur në mjerim nga vete këta moraliste. Mund të përmendim popullin kurd, cecen, shqiptarë të Serbisë dhe Maqedonisë, palestinez, irakënet e "cliruar", madje edhe haitianët( duke përmbledhur këtu të gjithë popujt në situata të ngjashme) të cilëve u imponohet një model politiko-ekonomik. Paradoksi më i madh është tipologjia e lirisë për mungesën e të cilave kritikohet Kina, liria e fjalës, e shtypit ajo e fesë me evidentim të Tibetit sikur ujugurët muslimanë nuk jetojnë të njëjtën situatë. Liritë e organizimit të punëtorëve, të respektimit të dignitetit dhe ekzistencës ku mund të grupohen shumë liri, nuk merren parasysh nga përfaqësuesit më të fuqishëm financiarë të këtyre politikave moraliste. Vendet më të fuqishme të botës kanë investuar miliarda dollarë në këtë treg krahu të lirë pune dhe lëndësh të para, miliona njerëz të dënuar me uri, humbje e vendit të punës, pa harruar fëmijët, prodhojnë markat më të famshme të botes "humane", të të njëjtës botë që kërkon t'ju mbrojnë liritë ! Përse politika nuk i kërkon financës dhe industrisë të mos shtrihet në një vend diktatorial ? Përse Franca dhe SHBA nuk i kërkojnë llogari investitorëve francezë dhe amerikan për impenjimin në fabrikat e tyre(në Kinë) të fëmijëve, të punëtorëve pa asnjë të drejtë, të pagesës minimale, të shfrytëzimit kafshërorë, të mungesës së pushimeve, të shndërrimit të punëtorit në skllav ? A nuk janë këto mohime të drejtash njerëzore të kërkuar nga vetë moralistët? Hipokrizia e globalizimit e mbështetur nga industria e manipulimit mediatic na serviret si Mesia laik i shekullit të ri, por, deri në këtë moment përveç mrekullirave në pasurimin e shpejtë të elitave dhe në varfërimin e po kaq të shpejtë të masave nuk perjetojmë tjetër mesianizëm. Në Mesjetë njeriu vlente 38 solda ndërsa kali 100. Sot, fokat dhe balenat vlejnë më shumë se situata e një popullsie të tërë.

Doan Dani



# NE IRAK SULMOHET PRESIDENTI AMERIKAN BUSH

**G**jate vizites se fundit te tij si president i SHBA, Bush, eshte perballur me nje incident i cili ka ndodhur gjate nje konference shtypi. Ne kohen qe po u pergjigjej pyetjeve, nje gazetar e ka gjuajtur dy here me kepuce presidentin amerikan duke e detyruar te tregojte aftesite e tij per t'u shpetuar ketyre gjuajtjeve, sepse ai eshte faktikisht edhe ushtarak te cileve u mesohet normalisht qe te ruhen nga goditjet e mundshme, qofshin ata edhe kepuce. Agresori, qe ndermori sulmin, u uarrestua dhe iu dorezua autoriteteve ushtarake per ta gjykuar. Akti i ketij gazetari beri shume buje, sepse ishte nje rast unik qe te sulmohej nje president amerikan kaq publikisht. Por, me aktin e tij, qe faktikisht eshte i guximshim, gazetari tashme vleresohet si hero aq sa, edhe parlamenti i Irakut nuk e ka denuar aktin e tij. Kepuca, qe u hodh kunder Bushit, e ka zbehur edhe me teper figuren e tij dhe rolin qe ai ka luajtur ne pushtimin e Irakut i cili, pikerisht

nga ky pushtim, po vuan nga nje lufte e ashpër civile, ku viktimat jane tashme me qindra mijra. Edhe numuri i ushtareve te kualicionit, qe vepron ne Irak, ka pesuar humbje te renda te cilat reflektohen tek nmuri i te vrareve qe i ka kaluar shifat 5000. Kjo tregon se sllogani, qe behet lufte ne emer te paqes ne Irak, nuk ka marre nje note kaluese, sepse lufta dhe paqa jane koncepte krejt te kunderta. Kepuca qe u hodh kunder presidentit amerikan ne Irak e ka zbehur edhe ceremonine e kthimit te komandove ushtarake ne Shqiperi nga Iraku te cilat iu paten bashkangjitur trupave ushtarake ne Irak, duke u bere pjese e pasojave me te cilat po ndeshet sot populli irakien. Jehona e kepuces qe u gjuajt ndaj presidentit Bush i ka kaluar tashme kufijte e Irakut .Nje milioner nga Arabia Saudite ka kerkuar qe t'i jepet njera nga keto kepuce ne shkemb te miliona dollareve . Sauditi i pasur deklaroi se kjo kepuce e ka vene ne vend imazhin e muslimaneve dhe kjo kepuce per mua vlen me shu-



me se tere pasuria ime. Ndersa fati igazetarit te arrestuar nuk dihet mire. Flitet per nje keqtrajtim ne burgun ku eshte izoluar, keqtrajtim qe filloi nga salla kur u arrestua, sepse po aty ai u kap me force nga floket prej agjenteve qe nuk u shkoi mendja se edhe kepuce

mund te perdoren per nje atentat simbolik edhe ndaj nje presidenti te nje supershteti.

Dritan Dani

## Firma ILIRIA sh.p.k. me qendër në Shkodër

**Pajisje për ambiente lokalesh**  
**Prodhim dyer e dritare**  
**Dhoma fëmijësh**  
**Pajisje kuzhine**  
**Pajisje zyrash**  
**Dhoma gjumi**

**Mobil/Cel: 00355 (0) 69 2523565**



## Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.  
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit  
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ  
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme  
**MISH HALLALL**

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

**Produkt Hallall**

**KLIENTË TË NDERUAR!  
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,  
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:  
sallam, suxhuk etj.**

**2- Piceri hallall**

**3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni  
por hallalli i vërtetë është vetëm  
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"  
Cel: 0692101893